



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 533/4 Prot

Tiranë, më 28.06.2021

V E N D I M

Nr.86, datë 28.06.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë të Vendimit nr. 6 datë 10.02.2021, marrë nga njësia përgjegjëse DAP, “Për skualifikimin e *** nga procedura e konkurrimit për ngritje në detyrë në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Mbështetëse të ZKA (DMZKA), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të Vendimit nr. 6 datë 10.02.2021, marrë nga njësia përgjegjëse DAP, “Për skualifikimin e ***** nga procedura e konkurrimit për ngritje në detyrë në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Mbështetëse të ZKA (DMZKA), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 533 prot., datë 16.04.2021, nëpunësi ***** ka ngritur pretendimin se skualifikimi i tij nga pjesëmarrja në konkurrimin shpallur me kod

#3498, nëpërmjet Vendimit nr. 6 datë 10.02.2021, marrë nga njësia përgjegjëse DAP, “Për skualifikimin e ***** nga procedura e konkurrimit për ngritje në detyrë në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Mbështetëse të ZKA (DMZKA), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”, vjen në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, të cilat rregullojnë këtë aspekt të ligjit, por pa përmendur dhe argumentuar se cilat janë shkeljet apo paligjshmëritë.

Për verifikimin e këtyre pretendimeve, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil administroi dhe shqyrtoi materialin shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunësit, si dhe dokumentacionin e marrë prej Departamentit të Administratës Publike, që materializon këtë procedurë administrative.

Shkaku i mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi lidhet me Vendimin nr. 6 datë 10.02.2021, të DAP, “Për skualifikimin e ***** nga procedura e konkurrimit për ngritje në detyrë në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Mbështetëse të ZKA (DMZKA), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”, me kod #3498.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së sqarimeve të dhëna si dhe dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ, rezulton se Departamenti i Administratës Publike, fillimisht, ka publikuar shpalljen me kod #3026, për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, për plotësimin e pozicionit “Drejtor në Zyrën (Drejtorinë) Mbështetëse ZKA, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”.

Pas përfundimit të procedurës së lëvizjes paralele pa kandidatë të kualifikuar, është vijuar me procedurën e ngritjes në detyrë, nga ku rezulton të jenë paraqitur 3 kandidatë, mes të cilëve edhe kandidati *****.

Në lidhje me këtë konkurrent, është paraqitur një ankesë denoncuese se ai ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, për shkak se para konkurrimit ka ushtruar detyrën “Drejtor” në CFCU, e cila është në vartësi dhe kontrollohet prej pozicionit që zhvillohet konkurrimi, kështu që në rast kualifikimi apo emërimi të ***** në pozicionin e punës si “Drejtor në Zyrën (Drejtorinë) Mbështetëse ZKA, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë” do të ndikonte në vlerësimin e punës të CFCU, ekziston mundësia që vendimmarrjet përsa i përket kontrollit dhe inspektimeve financiare, të ishin subjektive dhe të influencuara, nga përgjegjësia për punën e mëparshme.

Mbi këtë bazë, njësia përgjegjëse (DAP), me aktin nr. 25, datë 30.09.2020, ka vendosur pezullimin e procedurës me kod #3026, për ngritje në detyrë, për plotësimin e pozicionit “*Drejtor i Drejtorisë Mbështetëse të ZKA (DMZKA), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*”, me qëllim sqarimin dhe vlerësimin e faktit të ekzistencës së konfliktit të mundshëm të interesit në këtë rast.

Pasi është kërkuar mendimi i specializuar i ILDKPI-së, Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga BE, DRPR e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të tjerë dhe drejtorive përkatëse në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 18734/2 prot., datë 27.01.2021, Departamenti i Administratës Publike, njoftohet për vendimin e marrë nga autoriteti përgjegjës, Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA) lidhur me mundësinë e konfliktit të interesit të kandidatit ***** , për tu emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë Mbështetëse të ZKA (DMZKA), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*”.

Në shkresën e mësipërme, Zyrtari Kombëtar Autorizues, shprehet se: “*Bazuar në denoncimin për konfliktin e interesit, ardhur për kandidaturën e paraqitur nga ***** , në pozicionin “Drejtor në Zyrën (Drejtorinë) Mbështetëse ZKA, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”, pas një vlerësimi të kuadrit ligjor për menaxhimin e fondeve IPA dhe IPARD në Shqipëri, funksioneve të punës të DMZKA dhe Sektorit të Sigurimit të Cilësisë pranë CFCU, bazuar në manualet e procedurave të këtyre strukturave; dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe nga konsultimet me ekspertë të ndryshëm të vendeve homologe, ka rezultuar se: *****është një kandidaturë, e cila mund të ketë një konflikt të mundshëm interesi në funksionin e “Drejtorit në Zyrën (Drejtorinë) Mbështetëse ZKA, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”.*”

Bazuar sa më lart, Departamenti i Administratës Publike, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe neni 21, i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë ka vendosur;

1)Të skualifikojë dhe përjashtojë kandidatin ***** , nga procedura e ngritjes në detyrë për pozicionin “*Drejtor në Zyrën (Drejtorinë) Mbështetëse ZKA, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë*”, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me numër shpallje #3026;

2)Të shfuqizojë vendimin nr. 25, datë 30.09.2020, të DAP, “Për pezullimin e procedurës së ngritjes në detyrë, për pozicionin “Drejtor në Zyrën (Drejtoria) Mbështetëse ZKA, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”;

3)Të vijohet me procedurën e konkurrimit me numër shpallje #3026, në fazën në të cilën ishte pezulluar me vendimin nr. 25, datë 30.09.2020, të sipërcituar.

Meqenëse procedura e konkurrimit me shpallje #3026, u mbyll pa asnjë fitues, Departamenti i Administratës Publike, e rishpalli për konkurrim pozicionin “Drejtor i Drejtoria Mbështetëse të ZKA (DMZKA), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”, me kod #3498. Në këtë konkurrim, aplikoi edhe nëpunësi ******, të cilin njësia përgjegjëse e skualifikoi përsëri për të njëjtën arsye, për konflikt të mundshëm interesi.

Nisur nga gjithë sa u tha më sipër dhe pas analizës në tërësi të dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, arrihet në përfundimin se në këtë rast nuk konstatohen shkelje procedurale apo ligjore, të kryera/lejuara nga njësia përgjegjëse. Të gjitha veprimet dhe konkluzionet janë bazuar në analizën e bërë nga organizmat kompetente përkatëse, për ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit dhe janë të bazuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, ligjin nr. 9367, datë 07.05.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe vendimin nr. 14, datë 15.01.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2020”.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit nr. 6 datë 10.02.2021, të njësisë përgjegjëse (DAP), “Për skualifikimin e ***** nga procedura e konkurrimit me kod #3498, për ngritje në detyrë në pozicionin e

Drejtorit të Drejtorisë Mbështetëse të ZKA (DMZKA), në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”, dhe meqë nuk u konstatuan shkelje të dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, arkivimin e çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Departamentit të Administratës Publike, Ministria e Financave dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha